



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:141334
Datë: 13.02.2024
Numri i dokumentit: 05324229

C.nr.975/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN–Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, gjyqtari Baki Shigjeqi, duke vendosur në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit I.V. me numër personal me vendbanim në fshatin Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson K.V. me vendbanim në fshatin Komuna e Prizrenit, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson përfaqësuesja ligjore V.I.Xh. nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të pronësisë mbi bazën e mbajtjes në posedim dhe ndërtimit, vlera e kontestit 3,100.00 euro, jashtë seance me datë 13.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET** së është tërhequr padia me numër C.nr.975/19, e paditësit I.V. nga fshati Komuna e Prizrenit, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, për çështjen juridike me objekt kontesti vërtetimit të së drejtës së pronësisë në bazë të mbajtjes në posedim dhe ndërtimit.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi V. nga fshati Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, për shkak të vërtetimit të pronësisë mbi bazën e mbajtjes në posedim dhe ndërtimit, vlera e kontestit 3,100.00 euro.

Paditësi V. nga fshati Komuna e Prizrenit, me parashtresën e datës 05.02.2024, e ka njoftuar gjykatën se në këtë çështje juridike kontestuese e tërheq padinë ndaj të paditurës Komuna e Prizrenit.

Në seancën përgatitore të datës 13.02.2024, Gjykata në kuptim të nenit 261 par.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, e ka njoftuar të autorizuarën e të paditurës me parashtresën e paditësit për tërheqjen e padisë. E autorizuar e të paditurës në seancë ka deklaruar se nuk e kundërshton tërheqjen e padisë nga ana e paditësit në këtë çështje kontestimore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është konform nenit 450 lidhur me nenin 463 të LPK-së, pasi që pala e paditur nuk i ka specifikuar shpenzimet e kërkuar procedurale.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 par.2 e lidhur me nenin 387 par.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:141334, 13.02.2024

Gj y q t a r i,

Baki Shigjeqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi në kuptim të nenin 261 par.4 të LPK-së, nuk është e lejuar ankesa.